REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

01-111/01-47297
Datë 16.09.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u bazuar në nenin 81 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe paragrafi 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 11 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ndërlidhur me nenin 8 paragrafi 9 dhe nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Rregullores (QRK) numër 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistenteve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, **pas përfundimit të procedurës së verifikimit paraprak për Grupin e Arsimit**, në konkursin e publikuar me datë **08.09.2025** me numër reference **01-111/01-47297**, nxjerr ketë:

N J O F T I M

(*lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme*)

✓ **Mësimdhënës për lëndën e makinerisë**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i aplikacionit
1.	Haki Mulaj	47932

✓ **Mësimdhënës/Instruktor i mësimit praktik automekanik**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i aplikacionit
1.	Berat Bobi	49225

✓ **Mësimdhënës për lëndën e ndërtimtarisë/arkitekturës**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i aplikacionit
1.	Arben Ferizi	48844

✓ **Mësimdhënës për lëndën e gjuhës frënge**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i aplikacionit
1.	Alfred Buqaj	47815
2.	Fiona Kaqi	48968
3.	Vlera Dobroshi	49275

✓ **Mësimdhënës për lëndën e fizikës**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i aplikacionit
1.	Shkendije Berisha	49255

Të gjithë kandidatët e lartpërmendur ftohen me datën **18.09.2025 (e enjte) nga ora 14:00** të paraqiten në Sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për t'iu nënshtruar testit me shkrim.

Me vete duhet të keni letërnjoftimin dhe një laps kimik.

Për pozitat mësimdhënës/instruktor i mësimit praktik automekanik, mësimdhënës për lëndën e ndërtimtarisë/arkitekturës dhe mësimdhënës për lëndën e fizikës **në mungesë të kandidatëve të kualifikuar** kemi proceduar tutje sipas nenit 12 paragrafi 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe nenit 20 paragrafi 4 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ numër 05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

Kandidati për mësimdhënës/instruktor i mësimit praktik automekanik nëse rezulton kandidat i suksesshëm, gjatë verifikimit para emërimit duhet te sjellë dëshmitë relevante të përvojës së punës ndërsa kandidati për mësimdhënës për lëndën e ndërtimtarisë/arkitekturës nëse rezulton kandidat i suksesshëm, gjatë verifikimit para emërimit duhet te sjellë vendimin e ministrisë së arsimit për nostrifikimin e diplomës.

Për pozitat mësimdhënës për lëndën e transportit rrugor, mësimdhënës për lëndën e matematikës, mësimdhënës për lëndën e historisë dhe mësimdhënës për lëndën e gjeografisë **dështon** procedura për shkak të mungesës se kandidatëve, duke pamundësuar përmbushjen e kritereve të konkursit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kandidati i pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave në Komunën e Gjakovës brenda afatit prej tetë (8) ditëve pas datës së shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Kushtrim Brahimaj

Menaxher i Burimeve Njerëzore